Identitet që është i njohur në tërë rrjetin. Ky është koncept i rëndësishëm që përdoret nga [LAN](#) të ndërmarjeve. Kjo lejon ndërmarjeve të kontrollojnë cilët individë mund të përdorin cilat resurse si aplikacione,...

IEEE

Shqip: IEEE

IEEE (Institute of Electrical and Electronics Engineers) - Organizatë që përfshinë inxhinierë, shkenctarë, studenta të fushave të elektronikës dhe të gjitha fushave të lidhura me elektronikë. Kjo organizatë u themelua në vitin 1963,...

IETF

Shqip: IETF

IETF është shkurtesa për [Internet](#) Engineering Task Force. Kjo është një bashkësi ndërkombëtare e hapur e përbër nga dizajnerët e rrjetave, operatorët, shitësit dhe hulumtuesit të cilët meren me zhvillimin e arkitekturës së internetit....

Illyria

Shqip: Illyria

Illyria është emri i pjesës së softuerit e cila ekzekutohet në modin interpretues nën gjuhën programuese Lisp. [Illyria](#) shfrytëzohet kryesisht në institucionet edukacionale për demonstrimin e principeve për nxjerrjen e konkluzioneve mbi motorë....

IMDb

Shqip: IMDb

IMDb është shkurtesa për [Internet](#) Movie Database ku kjo është një bazë e të dhënave në Internet e cila ofron informata mbi aktorë, filma, emisione televizive, yje televizive, video lojëra si dhe personel produksioni....

Informatics

Shqip: Informatikë

Për shkak të zhvillimit të shpejt të informatikës ka definicione të ndryshme në gjuhë të ndryshme, por definicioni më i përshtatshëm rrjedh nga gjuha franceze, prej nga e ka prejardhjen edhe vet fjala informatikë,...

Intel

Shqip: Intel

Korporata [Intel](#) e cila u themelua më 1968 nën emrin **I**ntegrated **E**lectronics është kompania më e madhe botërore për gjysmëpërçues. [Intel](#)-i është më i njohur për mikroprocesorët e vet për [PC](#),...

Internet Explorer

Shqip: Internet Explorer

Internet Explorer (shkurtimisht [IE](#)) i cili poashtu njihet si [Windows Internet Explorer](#) (shkurtimisht WIE) apo [Microsoft Internet Explorer](#) (apo shkurtimisht [MSIE](#)) është një ueb-shfletues grafik i cili është i zhvilluar nga [Microsoft](#) dhe është i përfsh...

Internet

Shqip: Interneti

Interneti është bashkësi e milionave rrjetave lokale të lidhura ndërmjet vete, duke krijuar kështu rrjetin global të komunikimit. [Interneti](#) mund të konsiderohet si "rrjet i rrjetave".

interrupt

Shqip: interrupt

Në inxhinierinë kompjuterike, [interrupt](#) (ndërhyrja, ndërprerja, ndalja e përkohshme), është proces kur [CPU](#) e ndalon punën që është duke bërë, pasi që ka pranuar sinjal nga ndonjë pjesë tjetër harduerike për përkujdesje....

IP

Shqip: IP

Shkurtesa për [Internet Protocol](#). [IP](#) cakton formatin e paketave ose datagrameve dhe skemën e adresimit. [IP](#) bashkohet me [TCP](#) për të krijuar lidhje virtuale mes burimit dhe destinacionit. Ekzistojnë dy versione të IP,...

IR

Shqip: IR

Akronim për Infra Red (sq. Infra Kuq). [IR](#) është valë elektromagnetike me gjatësi valore rreth 1 μm (mikrometër). Quhen infra kuq për shkak se shtrihen në mes të spektrit të dukshëm të dritës (kuq) dhe radio valëve,...

[IRC](#)

Shqip: IRC

IRC, apo [Internet](#) Relay Chat, është servis i cili i lejon njerëzit në mbarë botën e internetit të lidhen dhe të bisedojnë e diskutojnë tema të ndryshme përmes [IRC](#) kanalave. Protokoli i [IRC](#) është [RFC 1459](#),...

[IrDA](#)

Shqip: IrDA

Infrared Data Association ose [IrDA](#) është organizatë vullnetare e prodhuesve të ndryshëm që përkujdesen që prodhimet infrakuqe në kompjutera, PDA, printera, kamera e të tjera bashkëpunojnë mes vete. Kjo shkurtesë gjithashtu përdoret për të emërtuar pr...

[irssi](#)

Shqip: irssi

irssi është një aplikacion cili funksionon si [IRC](#) klient. Ky aplikacion është i shkruar në gjuhën programuese C nga Timo Sirainen dhe është i lëshuar nën licencën [GNU GPL](#).

[irssi](#) fillimisht ishte shkruar për të funksionuar në sistemet e llojit Unix...

[ISBN](#)

Shqip: ISBN

Shkrutesë për "International Standard Book Number". [ISBN](#) është numër identifikues unik për libra dhe është menduar të përdoret komercialisht. [ISBN](#) është krijuar në Britaninë e Madhe më 1966 nga shtëpitë botuese,...

[ISDN](#)

Shqip: ISDN

ISDN (Integrated Services Digital Network) - quhet një lloj i veçantë i rrjetit të qarkut telefonik i krijuar për të mundësuar transmisionin digjital të zërit dhe të dhënave nëpërmes telave të bakrit, duke mundësuar kështu kualitet më të lartë dhe sh...

[ISO](#)

Shqip: ISO

ISO (International Organization for Standardization) - Organizatë internacionale për standardizime në shumë aspekte e themeluar në vitin 1946 dhe përfshin më se 100 shtete. Kjo organizatë ka për qëllim vënien e

standardeve internacionale....

ISS

Shqip: ISS

(I)

Stacioni Ndërkombëtarë Hapësinorë (SNH) është projekti më i madh dhe më i ndërlikuar shkencorë në histori. Projekti është i udhëhequr nga SHBA me 16 shtete tjera pjesëtare: Kanada, Japonia, Rusia dhe anëtarët e EU....

Java

Shqip: Java

Java është gjuhë programuese e orientuar në objekte e cila është pas zhvilluar në fillim të viteve 1990-ta nga James Gosling dhe kolegët e tij të kompanisë Sun Microsystems.

Në dallim nga gjuhët tjera programuese,...

JavaScript

Shqip: JavaScript

JavaScript (JS) është emri i implementacionit të standardit ECMAScript nga ana e korporatës Netscape Communications. JavaScript është me e njohur për nga shfrytëzimi i saj nëpër web-faqe në formë të skriptave të ekzekutuara nga ana e klientit,...

JAXA

Shqip: JAXA

JAXA është shkurtesa për agjensionin kombëtarë Japonez për hulumtimin hapësinorë (Ang. Japan Aerospace Exploration Agency). Ky agjension është formuar më 1 Tetor, 2003 me anë të bashkimit të tre organizatave të pavarura që ishin: Instituti për Shkenc...

Yotta

Shqip: Jota

(Y) Yotta është prefiks që vendoset para njësisë themelore. Në sistemin decimal të numërimit, prefiksi "jota" i vendosur para një njësie e shumëzon atë me 10^{24} . Në sistemin binar, prefiksi "jota" i vendosur para

një njësie e shumëzon atë...

JPEG

Shqip: JPEG

JPEG është fjalë për skedat e prodhuara me standardin [JPEG](#). Me krijimin e skedës [JPEG](#) caktohet cilësia e fotos, zakonisht në shkallë prej 1 deri më 10.

JPEG (Joining Photographic Experts Group) është standard i [ISO/IEC](#) grupit të ekspertëve që zhvil...

JPL

Shqip: JPL

JPL është shkurtesë për Jet Propulsion Laboratory. [JPL](#) është themeluar në 1936 në California Institute of Technology në Pasadena, California/SHBA. Roli i [JPL](#) në fillim ishte hulumtimi i raketave. JPL është e njohur për numrin e madh të misioneve hapë...

JSP

Shqip: JSP

JSP ([Java](#) Server Page) është teknologji për krijimin [dinamik](#) të përmbajtjes së një faqeje të internetit. [JSP](#) përdorë servlet, programe të vogla që ekzekutohen në server.

carbon

Shqip: karbon

Elementi kimik [Karbon](#) është i pranishëm në shumë përbërje. Karboni është elementi i dytë më i përhapur në Gjithësi. Ky element është një nga bazat e jetës. Ekzistojnë pesë alotrope të Karbonit: amorf, grafit,...

KB

Shqip: KB

KB është shkurtesë për KiloByte. Një [KB](#) i ka 1,024 bajta.

KDE

Shqip: KDE

KDE është mjedis i punës, apo "desktop environment", i cili punon për

makina të tipit Unix. [KDE](#) projekti është themeluar në Tetor 1996 me verzionin 1.0 të liruar me 12 Korrik 1998.

[kernel](#)

Shqip: kernel

Bërthama apo thelbi i Sistemit Operativ (SO). Kjo është pjesa e Sistemit Operativ që ngarkohet së pari dhe qëndron në [memorie](#). Pasi që është banor (resident) në memorie, është e rëndësishme që Kerneli të jetë i vogël dhe ofron shërbimet bazë të nevoj...

[X Client](#)

Shqip: Klienti X

Në sistemin X me dritare (x window sistem), klient X quhet cilido aplikacion (application) i cili mund të komunikoj me serverin X (x server), sipas protokollit X (x protocol). Ky klient në fakt paraqet cilindo aplikacion të cilin përdoruesi mund të a...

[km](#)

Shqip: km

Njësia metrike për kilometër. Një kilometër është 1000 metra ose 0.621371 mila.

[NAK](#)

Shqip: KNP

NAK është shkurtes për Negative Acknowledgement Code, Kodi Negativ i Pranimit, që është karakter kontrolle që i tregon dërguesit që porosia është pranuar nga [pranuesi](#) me gabime ose që është koruptuar gjatë transmetimit....

[compiler](#)

Shqip: kompiluesi

Është program i cili i dekodon instrukcionet të japura nga programeri dhe i kthen ato në gjuhë të makinës, të cilat shndërrohen në objekte kodore dhe mund të ekzekutohen kurdo që nevojiten. [Kompiluesi](#) e lexon kodin burimor (source code) dhe i organiz...

[Packet Switching](#)

Shqip: Komutim i paketave

Është njëra nga teknikat e komutimit (switching), ku komutimi bëhet për

çdo paket veç e veç ([packet](#)). Kjo bëhet e mundur duke e hapur paketën, duke e lexuar adresën e pranuesit, duke e mbyllur prapë paketën dhe duke e orientuar në drejtim të duhur....

concentrator

Shqip: koncentrator

(I)

Koncentratori është një lloj i multiplexor-it që kombinon kanale të ndryshme në një [medium](#) transmetues ashtu që kanalet individuale mund të përdoren në të njëjtën kohë. P.sh. ISP-të përdorin koncentratorët për të bashkuar lidhjet telefonika për ...

Limit Check

Shqip: Kontroll i vlerave kufitare

Është proces që verifikon vlerën e një madhësie e cila nuk guxon të dalë jashtë një brezi të paracaktuar. Nëse kjo vlerë del jashtë vlerave kufitare, atëherë aktivizohet një proces tjetër, me të cilin ndërmerren aksionet për kthimin e kësaj vlere bre...

controller

Shqip: kontrollor

Kontrolleri është pajisje që rregullon transferin e shënimeve nga një kompjuter në pajisje periferike ose anasjelltas. Disqet, tastaturat, ekranet, shtypësit kanë nevojë për [kontrollor](#). Zakonisht kontrolleri ndërtohet nga një qip i vetëm....

Kryptos

Shqip: Kryptos

Kryptos është emri i skulpturës të ndërtuar nga artisti Amerikan James Sanborn, që është e vendosur në objektin e [CIA](#) në Langley, Virginia (shqiptuar: Lenglli, Virgjinja) të ShBA-ve. Emri i skulpturës rrjedh nga fjala "kryptos" që në gjuhën Greke do ...

quark

Shqip: kuark

Kuarket janë një nga dy grupet e njohura të grimcave nënatomike që deri sot nuk janë ndarë. Këto janë grimca që njihen si njësitë më të vogla të materies. Ekzistojnë 12 grimca themelore, gjashtë kuarke dhe gjashtë leptone....

Backbone

Shqip: Kurriz

Është term që përdoret për të treguar pjesën kryesore (qendrore) të një sistemi, rrjeti, apo pajisjeje, duke e krahasuar me kurrizin e trupit njerëzor.

LaCie

Shqip: LaCie

LaCie është një kompani për harduer e cila është e specializuar në hard disqe, RAID matrica, disqe optik, si dhe monitorë. Kjo kompani merret me promovimin e disa llojeve të hard disqeve me kapacitete disa terabajtësh (**TB**) dhe me interfejsë të ndrysh...

LAN

Shqip: LAN

LAN (Local Area Network) është një grup i makinave të lidhura në të njëjtin medium të komunikimit që ndajnë resurset e rrjetit dhe që gjinden në hapësirë të vogël. LAN teknologjitë janë Ethernet, Token Ring dhe FDDI....

laptop

Shqip: laptop

Laptop është kompjuter që gjithashtu quhet fletore sepse mund të bartet lehtë. Laptop-i mund të punoj me bateria dhe të transportohet lehtë.

LED

Shqip: LED

LED është shkurtesë për Light Emitting Diode. Përbëhet nga p-n lidhja e cila emiton dritë. Gjerësia valore e dritës varet nga materiali ndërtues i diodës.

Linux

Shqip: Linux

Linux është zbatim i hapur (open source) dhe falas i UNIX i filluar nga Linux Torvalds, student nga Helsinki/Finlanda. Linux quhet kernel-i i

sistemit operativ [GNU/Linux](#) dhe punon në shumë arkitektura si [Intel](#),...

[Linux Journal](#)

Shqip: Linux Journal

Linux Journal ([LJ](#)) është një revistë mujore e cila publikohet nga kompania Specialized Systems Consultants (SSC) që gjendet në Seattle, Washington, ShBA.

Në [Linux Journal](#) kryesisht publikohen artikujt që kanë të bëjnë me të gjitha nivelet e zhvill...

[LiveCD](#)

Shqip: LiveCD

LiveCD është [CD](#) nisëse (Ang: bootable) e cila përmban një sistem operativ, së bashku me softuer tjetër. Sistemi operativ mund të ekzekutohet nga [CD](#)-ja, pa instalim në hard disk. Sistemi, apo kompjuteri,...

[Geolocation](#)

Shqip: lokalizim gjeografik

Ose përcaktim i vendndodhjes gjeografike. Është shprehje që zakonisht nënkupton shërbimin i cili mundëson përcaktimin e vendndodhjes gjeografike të një objekti apo personi. Shërbime të tilla mund të ofroj sistemi global i pozicionimit ([GPS](#)),...

[LUnix](#)

Shqip: LUnix

LUnix është një sistem operativ i llojit Unix i cili është i paraparë për kompjuterin shtëpiak të viteve 1980 të quajtur Commodore 64. [LUnix](#) përkrah komunikimin nëpërmjet [TCP/IP](#) (SLIP apo PPP duke e shfrytëzuar RS232 interfejsin)....

[magnitude](#)

Shqip: magnitudë

(I)

Matja e sasisë së dritës të pranuar nga objekti qiellorë. Objektet me [magnitudë](#) të vogël janë më të ndritshëm, këto objekte quhet objekte të

magnitudës së parë. Dallimi mes magnitudave është prej faktorit 2....

macro

Shqip: makro

Përdorimi fillestar i fjalës [makro](#) ishte në gjuhën [assembler](#) që nënkupton përhapjen e një instruksioni gjuhësor në më shumë instruksione. Kjo ishte e dobishme kur një instruksion duhej të përsëritej disa herë....

clock speed

Shqip: masa e shpejtësisë

Clock speed e kompjuterit shërben për sinkronizimin e gjitha komponenteve të makinës. Masa e shpejtësisë përbëhet nga cikli (apo një valë e sinjalit). Pra sinjali në shpejtësi 100 MHz ka 100 milion cikla në sekondë....

spoofing

Shqip: mashtrim

(I)

Mashtrimi i origjinës. Ky termin zakonisht përdoret për të emërtuar e-postën e dërguar e cila nuk i ka informatat dërguese autentike apo të vërteta në kokë. E-posta e tillë duket si e dërguar nga një adresë e caktuar por në të vërtet nuk është....

MB

Shqip: MB

MB është shkurtesë për MegaByte. Një [MB](#) është 1,048,576 bajta ose 1024 [KB](#). [MB](#) është njësi për matjen e kapacitetit memorik të kompjuterit. Me qëllim thjeshtimi MB zakonisht paraqitet si 1,000,000 bajta....

MCSA

Shqip: MCSA

Shkurtesë për [Microsoft Certified Systems Administrator](#), [MCSA](#) janë ata individ që në mënyrë të sukseshme kalojnë çertifikimet [A+](#), Network, si dhe kanë njohuri në [Microsoft Windows](#) NT, 2000, XP, 2003, si dhe versionet më të reja të [Microsoft-it](#)....

MCSE

Shqip: MCSE

Shkurtesë për [Microsoft Certified System Engineer](#), [MCSE](#) janë personat

që në mënyrë të sukseshme kanë kaluar provimet në marrëveshje me [Microsoft Windows](#) NT, 2000, XP, 2003, dhe në sistemet më të reja operative të [Microsoft-it](#),...

Medium

Shqip: Medium

Mund të ketë shumë kuptime në fusha të ndryshme, por ne do të ndalemi në disa sosh. Është: 1) Material nëpër të cilin transmetohet një sinjal elektrik që mund të jetë ajri, kabloja nga bakri ose kabloja me fije optike (optical cable);...

Media

Shqip: Mediume

Sipas anglishtes standarde, [media](#) është shumës i fjalës [medium](#) (Oxford English Dictionary). Prandaj në shqip duhet të përkthehet sikur mediume, edhe pse është bërë zakon të përdoret fjala media. Përfshinë të gjitha mjetet e komunikimit masiv,...

memory

Shqip: memorie

Kompjuteri përdorë [memorie](#) si [RAM](#) për të mbajtur informatat dhe udhëzimet, të nevojshme për të kryer detyrat e caktuara. Në këtë mënyrë, [CPU](#)-së (Central Processing Unit) i mundësohet hyrje më e lehte dhe e shpejte në informatat dhe udhëzimet e ruajtu...

METAFONT

Shqip: METAFONT

METAFONT është gjuha programuese që shfrytëzohet për përcaktimin e fonteve vektorike. Po të njëjtin emër mban edhe interpreteri që e ekzekuton [METAFONT](#) kodin. Detyra e këtij interpreteri është që të konvertoj fontet vektorike në bitmap fonte,...

scientific method

Shqip: metoda shkencore

Metoda Shkencore (Ang: Scientific Method) është mënyra e zbulimit të së vërtetë dhe fakteve, duke i ikur gabimeve. Përparësia më e madhe e metodës shkencore është që nuk ka paragjykime, pra nuk bazohet në besim por në vërtetime përmes eksperimenteve....

meter

Shqip: metri

Metri, njësia m, është baza e sistemit metrik. Në fillim [metri](#) është definuar si 1/10,000,000 e distancës prej ekuatorit deri tek polet e Tokës por sot metri është i definuar si distanca mes dy vijave në një shkop që mbahet në Serves/Francë afër Pari...

Microsoft

Shqip: Microsoft

Microsoft-i është një korporatë ndërkombëtare e cila është e specializuar në teknologjinë kompjuterike. Në bazë të dhënave nga Korriku i 2006, kjo korporatë ka rreth 71,553 punëtorë në 102 vende dhe regjione....

Microsoft Windows

Shqip: Microsoft Windows

Microsoft [Windows](#) (shkurtimisht [MS Windows](#) apo MSW) është emri i familjes të sistemeve operative nga korporata [Microsoft](#). Këta sisteme operative janë në gjendje të funksionojnë në platforma si serverë,...

micron

Shqip: mikron

Mikron është emri për mikrometër apo μm 10^{-6} m.

MIT

Shqip: MIT

(I)

Shkurtesë për Massachusetts Institute of Technology në Cambridge, Massachusetts/SHBA. Institut i njohur teknologjik ku janë bërë hapat e parë në kompjuterikë. [MIT](#) është themeluar në 1865 nga Gjeologu William Barton Rogers....

MMC

Shqip: MMC

(I)

[MMC](#) është shkurtesë për MultiMediaCard. Ky format për [memorie](#) është i hapur dhe zakonisht përdoret në telefona dhe [MP3](#) lexues. [MMC](#) vjen me kapacitete të ndryshme. Madhësia e MMC është sa një pullë postale....

mod

Shqip: mod

(I)

Ndryshime harduerike në kompjuter, konsolë, makinë apo pajisje të ndryshme elektronike. Mod-at e zakonshëm janë dritat në shtëpizat e kompjuterave apo sistemet e shtuara për ftohje.

(II)

Në terminologjinë e lojrave kompjuterike [mod](#) janë ndrysh...

[modem](#)

Shqip: modem

Shkurtesë për MOdulator-DEModulator. Modemi është pajisje harduerike që i mundëson kompjuterit të transmeton informata përmes lidhjes analoge telefonike. Modemi bën shëndrimin e sinjaleve digjitale në ato analoge për t'i transferuar ato nëpër [medium](#),...

[ADSL Modem](#)

Shqip: Modemi ADSL

Është [modem](#) që mundëson hyrjen në rrjetin e Internetit, duke shfrytëzuar rrjetin telefonik dhe duke mundësuar shpejtësinë shumë më të madhe se sa me metodën e thirrjes telefonike (dial-up). Ky [modem](#) shërben për modulimin e sinjalit në shkuarje (modul...

[MODS](#)

Shqip: MODS

(I)

Shkurt për Metadata Object Description Schema e zhvilluar nga Library of Congress në SHBA. Kjo [XML](#) skemë bibliografike përdoret për shumë gjëra e sidomos për nevoja të bibliotekave.

(II)

Shkurt për Multiplexed Optical Data Storage....

[MOLA](#)

Shqip: MOLA

MOLA është shkurtesë për instrumentin Mars Orbiter Laser Altimeter.

[MOLA](#) është e vendosur në orbituesin Mars Global Surveyor (MGS) të [NASA](#). Instrumenti transmeton pulse të laserit infrakuq në drejtim të Marsit në frekuencen prej 10 Hz....

[Mozilla](#)

Shqip: Mozilla

Emri origjinal i shfletuesit të Netscape. Emri [Mozilla](#) përbëhet nga Mosaic dhe Godzilla. Disa mendojnë që kjo nënkupton vrasje e Mosaic (sepse Godzilla është bishë që vret) që në atë kohë ishte shfletuesi numër një....

[MP3](#)

Shqip: MP3

MP3 është emërimi i shkurtë dhe më i shfrytëzuar për formatin enkodues dhe kompresues për zë digjital MPEG-1 Audio Layer 3. Ky format ka për qëllim që të shfrytëzoj sa më pak të dhëna për të shfaqur zërin në një kualitet pothuajse të njëjtë me format...

[MP4](#)

Shqip: MP4

MP4 ose ndryshe [MPEG-4](#) Video File janë skeda që shoqerohen zakonisht nga skedat BIF ose më mire BIFS (Binary Format for Scenes). Sa i përket leximit, ky format mund të përdoret me shumë programe të ndryshme (pothuajse të gjitha programet për leximin...

[MS-DOS](#)

Shqip: MS-DOS

[MS-DOS](#) është shkurtesa për [Microsoft Disk Operating System](#) ku ky është emri i sistemit operativ që është komercializuar nga korporata [Microsoft](#). Ky sistem ka qenë më i shfrytëzuar nga të gjithë sistemet operative të familjes [DOS](#),...

[MSN](#)

Shqip: MSN

MSN është shkurtesa për [Microsoft Service Network](#) dhe paraqet emrin për grumbullin e [Internet](#) shërbimeve që janë të ofruara nga korporata [Microsoft](#). [MSN](#) sipërfaqësoi fillimisht më 1995-en së bashku me sipërfaqësimin e sistemit operativ [Microsoft](#) Wind...

[MySpace](#)

Shqip: MySpace

MySpace është faqe për krijimin e rretheve shoqërore, ku përsipër kësaj kjo faqe ofron edhe publikimin e profileve personale, [blog](#)-ave, fotografive, muzikës dhe video materialit. [MySpace](#) poashtu përmban në

vete makinën interne kërkuese si dhe sistemi...

MySQL

Shqip: MySQL

MySQL është një lloj i bazës së shënimeve Structured Query Language, apo SQL. Kjo bazë e shënimeve si shumica e ka gjuhën e vetë me të cilën përdoruesi komunikon për t'i thirrur të dhënat, apo për të i ruajtur ato....

NAND

Shqip: NAND

Lloj i derës ([gate](#)) logjike ku në rast se dy hyrjet janë 1 atëherë rezultati është 0, ndërsa kur vetëm një nga inputet është 0 atëherë rezultati është 1.

A	B	A <u>NAND</u> B
0	0	1
0	1	1
1	0	1
1	1	0

NAND ...

nanoanalysis

Shqip: nanoanaliza

Nanoanaliza është mënyra që vendos mbi strukturat atomike të materialeve, sidomos kristaleve. Kjo është teknologji e ngjajshme me mikroanalizën por në nivel nanometrik. Mikroskopi elektronik përdoret shpesh për nanoanalizë,...

nanochip

Shqip: nanochip

Nanochip është qark i integruar (CHIP) por në madhësi nanometrike.

nanocomputer

Shqip: nanokompjuter

Kompjuter i cili i ka përmasat mikroskopike. Disa lloje të nanokompjuterëve janë duke u hulumtuar do të punojnë në mënyre të

ngjajshme me kompjuterat tradicional por dallojnë në përmasa, nanokompjuterët kimik dhe biokimik që bëjnë procesimin e inform...

[nanolitography](#)

Shqip: nanolitografi

Është arti i shtypjes, shkrimit apo grithjës në nivelin mikroskopik ku dimensionet janë me përmasa nanometrike. Instrumentet e përdorura në [nanolitografi](#) janë Scanning Probe Microscope (SPM) dhe Atomic Force Microscope (AFM)....

[nanomachine](#)

Shqip: nanomakina

Gjithashtu njifen me emrin nanite, janë pajisje elektromekanike të masës nanometrike. Disa pajisje janë testuar me sukses mirëpo hulumtimet shkencore ende vazhdojnë në këtë drejtim. Shembuj të naniteve ekzistuese janë sensorët që janë 1....

[nanometer](#)

Shqip: nanometer

Njësia matëse në vlerë 10^{-9} metra ose një e trilionta pjesë e metrit.

[nanomedicine](#)

Shqip: nanomjekësia

Është zbatimi i nanoteknologjisë në mjekësi.

[nanofabrication](#)

Shqip: nanoprodhimi

Dizajnimi dhe prodhimi i pajisjeve në dimensione nanometrike.

[nanorobot](#)

Shqip: nanorobot

Nanorobot është makinë robotike e specializuar në një punë të cilen e mbaron me precizitet dhe përsëritje. Nanorobotët kanë përmasa nanometrike. Nanorobotët mund të ndahen në dy grupe robotët autonom dhe insekte....

[nanostorage](#)

Shqip: nanoruajtje

Nanoruajtje nënkupton vendosjen e shënimeve në pajisje të ndërtuara ose që zbatojnë koncepte të nanoteknologjisë. Në këtë mënyrë rritet kapaciteti për ruajtjen e shënimeve. Disa metoda për [nanoruajtje](#) janë në zhvillim si teknologjitë optike dhe hologr...

[nanosecond](#)

Shqip: nanosekondë

Është njësi matëse e kohës me vlerë 10^{-9} e sekondës apo një e trilionta pjesë e sekondës. Zakonisht ns (ose nsec) përdoret për matjen e shpejtësisë së [RAM](#).

[nanotech](#)

Shqip: nanoteknologji

Nanoteknologjia apo si quhet ndonjëherë prodhimtaria molekulare është degë e inxhinierisë që merret me prodhimin e qarqeve elektronike të përmasave nanometrike (në nivelin molekular).

[nanotransistor](#)

Shqip: nanotranzistorë

Nanotranzistori është [tranzistor](#) por me përmasa nanometrike.

[nanotube](#)

Shqip: nanotuba

Procesi i prodhimit të tubave, me procese nanoteknologjike, në madhësi nanometrike. Nanotubat janë cilindra të gjatë të ndërtuar nga molekulat e grafitit me strukturë gjashtë-këndëshe. Nanotubat mund të kenë një apo më shumë cilindra....

[NASA](#)

Shqip: NASA

NASA shkurtesë për National Aeronautics and Space Administration. Kjo është agjenci shtetërore e SHBA roli i të cilës është hulumtimet jo-ushtarake dhe studimet shkencore të Hapësirës dhe Gjithësisë. [NASA](#) gjithashtu është zhvilluese e shumë teknologj...

[Neon](#)

Shqip: Neon

Neoni (Ang: [neon](#)) është elementi kimik i cili në sistemin periodik e ka simbolin Ne dhe numrin atomik 10. Ky element është një gaz fisnik inert,

pa aromë, pa ngjyrë, dhe pa shije.

Pesha atomike e neonit është 20....

NetBEUI

Shqip: NetBEUI

NetBEUI ([NetBIOS](#) Extended User Interface) është verzion i zgjeruar i [NetBIOS](#). [NetBEUI](#) formalizon formatin e frame-it të caktuar nga NetBIOS. [NetBEUI](#) është zhvilluar nga IBM dhe adoptuar nga [Microsoft](#). Konfigurimet më të zakonshme janë kur NetBEUI për...

NetBIOS

Shqip: NetBIOS

NetBIOS (Network Basic Input/Output System) është program që lejon aplikacionet në kompjuterë të ndyshëm të komunikojnë përmes [LAN](#). Është krijuar nga IBM dhe adoptuar nga [Microsoft](#). [NetBIOS](#) përdoret në rrjetat [Ethernet](#) dhe Token dhe bënë pjesë në N...

NetInfo

Shqip: NetInfo

NetInfo është bazë e të dhënave hierarkike administrative të OS X makinave dhe rrjetave. [NetInfo](#) përmban përdoruesit, grupet, makinat, shërbimet, lokacionet, direktoriumet dhe shënime tjera administrative....

NFA

Shqip: NFA

NFA është shkurtesë për "Nondeterministic Finite Automaton" apo "Nondeterministic Finite State Machine" është makinë e gjendjeve të kufizuara ([FSM](#)) ku prej secilës gjendje, ekzistojnë një apo më shumë tranzicione për një simbol të caktuar që dallon ng...

NIC

Shqip: NIC

(I)

Shkurtesë për Network Interface Card. [NIC](#) është kartelë e cila instalohet në kompjuter, dhe mundëson lidhjen e kompjuterit në rrjetë me kabëll ose patela. [NIC](#) kartela është e dizajnuar për rrjetë të caktuara - me protokole të vecanta dhe tekno...

NIM

Shqip: NIM

(I)

Shkurtesë për [NetInfo](#) Manager. [GUI](#) aplikacion për vëzhgimin dhe manipulimin e [NetInfo](#) bazës së shënimeve (nldb).

(II)

Shkurtesë për Nuclear Instrumentation Module që përdoret për numërimin e fotoneve për transmetimin e pulseve nëpër kablla "co...

NIS

Shqip: NIS

Shkurtesa për Network Information Service, metodë për përhapjen e shënimeve që përdoret në Sun makina. Në fillim quhej Yellow Pages por për arsye të hedhjes në gjyq nga British Telecom, e cila ishte pronare e shenjës dalluese (trademark) Yellow Page...

one's-complement

Shqip: një-komplementi

Reprezentim i numrit me shenjë në sistem binar. Ndryshe nga matematika kur numri negativ shënohet me shenjën minus (-), në sistemet digjitale kjo mund të arrihet kur numri 1 kthehet në 0, dhe ai 0 në 1....

NOR

Shqip: NOR

Lloj i derës ([gate](#)) logjike ku dajla është 1 nëse vetëm dy hyrjet janë 0, përndryshe rezultati është 0.

A	B	A NOR B
0	0	1
0	1	0
1	0	0
1	1	0

[NOR](#) është kombinim i [NOT](#) dhe [OR](#)....

normalization

Shqip: normalizim

(I)

Procesi i normalizimit në baza të shënimeve relacionale do të thot

organizimi i shënimeve në mënyrë që t'i iket përsëritjeve. Me procesin e normalizimit arrihet deri te ndarja e BSh në disa tabela dhe duke i definu relacionet mes tyre....

NOT

Shqip: NOT

Lloj i derës ([gate](#)) logjike ku vlera e hyrjes shëndrohet në atë të kundërt. Pra kur hyrja është 0, rezultati është 1 dhe e anasjelltas.

A NOT(A)

0	1
1	0

Notepad

Shqip: Notepad

Notepad është një tekst editor i thjeshtë i cili është i përfshirë në të gjitha versionet e sistemit operativ [Microsoft Windows](#) që nga versioni 1.0 më vitin 1985.

[Notepad](#) është një nga tekst editorët që shfrytëzohet më së shumti....

nova

Shqip: nova

Nova manifestohet me eksplohimin e madh dhe të shkëlqyeshëm të yllit. Eksplohimin [nova](#) shkaktohet nga bashkëveprimi i dy yjeve që gjinden afër. Këto yje e tërhiqen duke kapur atmosferën e njëri tjetrit....

NTFS

Shqip: NTFS

Shkurtesa për NT File System. Ky sistem i skedave është i paraparë për NT verzionet e [Windows](#). [NTFS](#) ofron përmirësime të shumta si "transaction logs" apo shënimet mbi transaksione që lejojnë kthimin e skedave të humbura në rast të prishjës së diskut....

sniffing

Shqip: nuhatje

Lloj i teknikës që përdoret në rrjeta ku sulmuesi ka mundësinë e mbledhjes së paketave në rrjetë. Nuhatja e paketave mundësohet përmes [NIC](#)-ave të vendosur në menyrenë e operimit që quhet "promiscuous".

[NIC](#)-at në këtë menyrë të operimit pranon gjitha p...

[prime number](#)

Shqip: numër i thjeshtë

Në matematikë, [numrat e thjeshtë](#) (Ang: [prime numbers](#)), janë të gjithë numrat natyral më të mëdhenj se 1, të cilët plotëpjestohen me vetëm vetveten dhe me numrin 1. Numrat natyral që janë më të mëdhenj se 1,...

[fibonacci numbers](#)

Shqip: numrat e fibonaçit

Në matematikë [numrat e fibonaçit](#) prodhojnë varg ashtu që çdo numër është i barabartë me shumën e dy numrave paraprak. Këta numra e kanë marrë emrin në bazë të matematicientit italian Leonardo Pisano (Fibonacci) i cili i zbuloi....

[NVRAM](#)

Shqip: NVRAM

Gjithashtu njihet me emrin Non-Volatile [RAM](#). Ky është një lloj i [RAM](#)-it [statik](#) që nuk i humb shënimet kur furnizimi me energji elektrike ndalet. NVS zbatohet me anë të baterisë që mban shënimet në EPROM nga [NVRAM](#)-i....

[OCW](#)

Shqip: OCW

MITOPENCOURSEWARE është iniciativë e Fondacionit William dhe Flora Hewlett, Fondacionit Andrew W. Mellon dhe [MIT](#). Qëllimet e [OCW](#) janë publikimi falas i materialeve të lëndëve mësimore të [MIT](#) për edukatorët,...

[OLE Automation](#)

Shqip: OLE Automation

Në fushën e programimit të aplikacioneve për [Microsoft Windows](#), termi [OLE Automation](#) nënkupton mekanizmin e bazuar në [COM](#) i cili mundëson komunikimin ndërmjet proceseve. Me saktësisht, ky mekanizëm ofron një infrastrukturë ku aplikacionet të cilat nj...

[OLE DB](#)

Shqip: OLE DB

OLE [DB](#) (poashtu e shënuar si [OLEDB](#) ose [OLE-DB](#)) është një API i dizajnuar nga [Microsoft](#) për arsye të qasjes ndaj llojeve të ndryshme të shënimeve që janë të deponuar në mënyrë të njëjtë. Më saktësisht, [OLE DB](#) është një grup i interfejsëve që janë të i...

[OLED](#)

Shqip: OLED

OLED është shkurtesë për Organic [LED](#). Këto Light Emitting Diode ([LED](#)) përbëhen nga molekulat organike. Kjo lejon krijimin e LED më të vogla të cilat mund të përdoren për ekrana [OLED](#) që do të jenë më të hollë,...

[OLPC](#)

Shqip: OLPC

The [Children's Machine](#) që poashtu njihet si [2B1](#) është një lloj i laptopit (kompjuter fletore) që është i paraparë që ti jep çdo fëmiu në botë qasje ndaj diturisë dhe formave moderne të edukimit. Ky [laptop](#) më herët është pas quajtur laptopi i 100 doll...

[Ohm](#)

Shqip: Om

Është njësi për matjen e rezistencës elektrike (resistance) të një elementi apo qarku elektrik, në sistemin ndërkombëtar të njësive (SI). Vlera ekzakte e një omi është: $1 \Omega = \text{kg} \times \text{m}^2 \times \text{s}^3 \times \text{A}^{-2}, \dots$

[OOP](#)

Shqip: OOP

Shkurtesë për Object-Oriented Programming. Programimi i orientuar në objekte është një ndër paradigmën (modelet) e gjuhëve programuese. Ky model bazohet në krijimin e tërësive të quajtura objekte, për dallim nga modelet tjera (psh modeli procedural a...

[open source](#)

Shqip: open source

Open Source në përgjithsi i referohet programit, kodi i të cilit është i hapur dhe i gatshëm për publikun e përgjithshëm për përdorim, ndryshim e përhapje falas. Në përgjithsi kodi [open-source](#) krijohet nga kontributi i shumë programerëve,...

OpenGL

Shqip: OpenGL

OpenGL (Open Graphics Library) është standardi industrial për aplikimin e API për definimin e 2D dhe 3D pamjeve grafike. Para krijimit të [OpenGL](#) nevojiteshin aplikacione grafike për çdo sistem operativ dhe platformë....

OpenSSL

Shqip: OpenSSL

OpenSSL është implementimi "[open source](#)" i protokolit [SSL](#) dhe TLS. Libraria kryesore e këtij implementimi që është e shkruar në gjuhën programuese C, e kryen implementimin e funksioneve bazike kriptografike si dhe ofron funksione tjera të ndryshme....

OR

Shqip: OR

Lloj i derës ([gate](#)) logjike ku rezultati është 1 në rast se së paku një nga hyrjet është 1, ndërsa 0 vetëm kur dy hyrjet janë 0.

A	B	A OR B
0	0	0
0	1	1
1	0	1
1	1	1

orkut

Shqip: orkut

Orkut është një rrjet shoqëror [Interneti](#) që është i ofruar nga [Google](#). Ky rrjet është i dizajnuar me qëllim që shfrytëzuesit e tij ta kenë mundësinë për takimin e personave të rinj si dhe mirëmbajtjen e lidhjeve ekzistuese që e kanë me persona tjerë....

OSD

Shqip: OSD

(I)

Shkurtesë për on-screen display. [OSD](#) është imazh i mbivendosur në ekran. Ky imazh zakonisht shërben për të bashkëvepruar me pajisjen me anë të instruksioneve që shfaqen në ekran. [OSD](#) zakonisht përdoret për pajisjet si TV,...

OSPF

Shqip: OSPF

OSPF shkurtesë për [Open Shortest Path First](#). [OSPF](#) është protokol rrugëtues autonom (IGP) i tipit "link-state". Ky protokol përdor algoritmin e njohur të Dijkstra (lexo: dekstra) për të gjetur rrugën më të shkurtër në [pemë](#) (Ang: [tree](#)) prej burimit në...

P2P

Shqip: P2P

P2P ose [peer-to-peer](#), është model i komunikimit ku dy makina janë në lidhje direkte dhe jo përmes ndonjë makine në mes. Në [P2P](#) çdo makinë në lidhje mund të fillon ose ndal lidhjen. Zakonisht në [P2P](#) të dy makinat kanë mundësi klient dhe server....

wireless

Shqip: pa tela

Wireless apo komunikim patela në kuptim të gjerë nënkupton lidhje apo komunikim përmes radio valëve dhe jo përmes mediumit fizik si telat apo kabllat optik. Komunikimi patela mund të jetë [WiFi](#), [Bluetooth](#),...

packet

Shqip: paketi

(I)

Paketi është njësi transportuese e të dhënave që përbëhet nga informatat binare. Secila [paketë](#) përmban sasi të të dhënave. Gjatësia maksimale e paketit varet nga mjeti i komunikimit, p.sh në teknologjinë [Ethernet](#),...

partition

Shqip: particion

Pjesë e ndarë e diskut. Particionet zakonisht përdoren për të ndarë sistemin operativ nga skedat e tjera. Një disk 1 [GB](#) mund të ndahet në dy particione 500 [MB](#). Sistemi i skedave qëndron në [particion](#) dhe një kompjuter mund të ketë particione të [SS](#) të ...

PB

Shqip: PB

PB është shkurtesë për Peta Bajta. Vlera e një [PB](#) është 1,024 [TB](#) apo 2 në

fuqinë 50. Një [PB](#) është 1,125,899,906,842,624 Bajta.

[PC](#)

Shqip: PC

(I)

Shkurtesë për kompjuter personal (Ang: Personal Computer). Fillimisht [PC](#) iu është referuar IBM [PC](#) që janë prodhuar nga IBM, para serive PS/2. Çdo kompjuter i përputhshëm me atë të IBM quhet PC. Tani PC poashtu i referohet gati çfarëdo kompjuteri ...

[PCB](#)

Shqip: PCB

PCB është shkurtesë për Printed Circuit Board. Kjo është pllakë në të cilën vendosen [RAM](#) modulet, qipat e ndryshëm dhe elektronika e nevojshme për t'a mundësuar funksionimin e një kompjuteri apo pajisje....

[PCI](#)

Shqip: PCI

Shkurtesë për Peripheral Component Interconnect, [PCI](#) është zhvilluar nga [Intel](#) si zgjerim për ISA bus.

[PCMCIA](#)

Shqip: PCMCIA

Akronim për Personal Computer Memory Card International Association. Kjo organizatë zhvillon standarde që definojnë karakteristikat fizike, elektronike, softuerike të pajisjeve të vogla të madhësisë së kartelave kreditore....

[PDP](#)

Shqip: PDP

(I)

Çdo protokol që transmeton shënimet në formë të paketave si [IP](#) ose X.25.

(II)

Paraardhësi i VAX arkitekturës nga Digital Equipment Corporation)
DEC)

(III)

Segment i rrjetit që përkrahë mekanizma përmes të cilave funksionet e mirëmbajtjes së ...

PDP-7

Shqip: PDP-7

PDP-7 është minikompjuter i prodhuar nga Digital Equipment Corporation (DEC) me 1965. Ky minikompjuter është i pari që ka përdorur Flip Chip teknologjinë dhe kushtonte \$72,000, lirë për standardet e viteve 60-ta....

Perl

Shqip: Perl

Shkurtesë për "Practical Extraction and Reporting Language". [Perl](#) është gjuhë interpretuese skriptuese e dizajnuar më shumë për procesim të teksteve. Zhvillimi i [Perl](#)-it ka filluar në vitin 1987 nga Larry Wall dhe është zhvilluar si [open source](#)....

perpendicular

Shqip: perpendikular

(I)

Teknologjia [perpendikulare](#) lejon ruajtje të kapacitetit të lartë duke përdorur regjistrim vertikal. Kjo lejon dyfishimin e kapacitetit për disqet tradicionale. Pritet se disqet e tilla mund të arrijnë kapacitet 230 [GB](#) për inq katror....

PGP

Shqip: PGP

PGP është shkurtesë për Pretty Good Privacy. [PGP](#) paraqet një aplikacion i cili shfrytëzohet për enkriptim të sigurtë të informatave. Çka e dallon [PGP](#)-ën nga aplikacionet tjera është aplikimi i enkriptimit asimetric....

PHP

Shqip: PHP

PHP është gjuhë skriptuese e dedikuar për të zhvilluar [web](#) aplikacione. [PHP](#) ([PHP](#) është shkurtese rekursive e "Hypertext Preprocessor") është njëra ndër gjuhët më të përhapura skriptuese që janë të bazuara në burimet e hapura ([Open Source](#))....

phpBB

Shqip: phpBB

phpBB (shkurtesë për "[PHP Bulletin Board](#)") është emri i forum sistemit të lirë dhe me kod burimor të hapur që është i shkruar në gjuhën programuese [PHP](#).

Fuqitë e [phpBB](#) qëndrojnë në pikat vijuese:

1....

[point-to-point](#)

Shqip: pikë-në-pikë

Lloj i qarkut që lidhë dy pika drejtpërdrejt. Lidhja logjike mes dy pikave nuk kalon nëpër pika tjera edhe pse lidhja fizike zakonisht kalon. Këto qarqe njihen edhe si lidhje të kushtuara (ang: dedicated)....

[LHC](#)

Shqip: PMH

LHC është shkurtesë për Large Hadron Collider apo Përplasësi i Madh i Hadroneve. [LHC](#) është instrument fizik i përmasave të mëdha. LHC përbëhet nga tunelet nëntokësore dhe LHC shpejtësuesin. Diametri i tuneleve është disa [km](#)....

[PoE](#)

Shqip: PoE

PoE apo [Power over Ethernet](#), është teknologji e cila i lejon sistemeve të mbartin rrymën elektrike, së bashku me shënime, përmes telave standard çift nëpër rrjetin [Ethernet](#). Kjo teknologji është shumë e dobishme për pajisjet si [IP](#) telefonat (shih: Vo...

[polygon](#)

Shqip: poligon

(I)

Poligoni është figurë e mbyllur gjeometrike e përbër nga 3 apo më shumë brinjë. Poligon i drejtë është ai që i ka brinjët e barabarta.

(II)

Poligon nënkupton detalizimin e objekteve 3D. Sa më shumë poligone aq më shumë detale mund të paraqite...

[POLS](#)

Shqip: POLS

Në dizajnin e gjuhëve programuese si dhe në dizajnin e interfejsave parimi [POLS](#) (shkurtimisht për [Principle of Least Surprise](#)) thotë që kur ekziston konflikti ndërmjet dy elementeve të interfejsit ose kur elementet kanë më shumë se një kuptim,...

postfix

Shqip: postfix

Shërbim për dërgimin e e-postës i paraparë për zëvendësimin e Sendmail. [postfix](#) punon në [Linux](#), [UNIX](#), [HP-UX](#), [Solaris](#) dhe Mac OS X. Ky shërbim është zhvilluar nga Wietse Venema.

POTS

Shqip: POTS

Kjo është shkurtesë për Plain Old Telephone Service. Kjo nënkupton shërbimin themelorë telefonik që ofron vetëm një lidhje telefonike në rrjetin "switched" publik. Funksionet e vetme të mundshme janë pranimi dhe bërja e thirrjeve....

receiver

Shqip: pranuesi

Pajisje roli i të cilës është pranimi i sinjaleve dhe përdorimi apo shëndrimi i tyre për qëllime të caktuara. Pranuesi është pajisje elektronike e cila përmban qarqet e nevojshme për manipulimin e sinjalit elektromagnetik....

proxy server

Shqip: proksi server

Proksi serveri (Ang: [proxy server](#)) është një kompjuter që ofron mundësi që klientët e tij të bëjnë kyçje indirekte ndaj shërbimeve të rrjetave të ndryshme. Pra, klienti kyçet në [proksi server](#) dhe pastaj bën kërkesë për një lidhje rrjeti,...

pseudocode

Shqip: pseudokod

Pseudokodi është formë e përgjithshme se si të zgjidhet një problem i caktuar pa detaje sintaksore. Pseudokodi është përshkrim se si punon një [algoritëm](#) zakonisht me anë të fjalëve duke i evituar detajet sintaksore të gjuhëve programuese....

KDC

Shqip: QDC

KDC është shkurtesë për Key Distribution Center ose Qendra për Distribuim të Çelsave. [KDC](#) është paket i përbërë nga proceset, formulat,

kodimi dhe dekodimi i përdorur në sisteme enkriptuese për të siguruar shkëmbimin e sigurtë të çelsave kriptues....

CERN

Shqip: QEHB

CERN është shkurtesë për Centre Européen de Recherche Nucléaire në Gjuhën Frengje që përkthehet në Qendra Europjane për Hulumtime Bërthamore. [CERN](#) është themeluar me 1954 dhe ishte një ndër projektet e para ku shtetet Europjane bashkëpunuan me sukses ...

Call Center

Shqip: Qendër e thirrjeve

Është një vend ku janë të grupuar disa, apo shumë njerëz, me detyrë që t'i përgjigjen thirrjeve të klientëve, me mjete të ndryshme për telekomunikim (telefon, telefaks, kompjuter, ..). Këso lloj qendrash krijohen nga shumë ndërmarrje,...

RDA

Shqip: QLBSH

RDA është shkurtesë për Remote Database Access ose Qasje e Largët e Bazës së Shënimeve.

QoS

Shqip: QoS

Shkurtesa për Quality of Service. Kjo mundësi ose aftësi e teknologjive lejon caktimin e përparësisë dhe garanton hapësirën transmetuese (ang: [bandwidth](#)) për aplikacione specifike në rrjet. Kjo lejon arritjen e cilësisë së kërkuar nga ana e aplikacio...

Kuadrofoni

Shqip: Quadrphony

Është njëri nga sistemet për regjistrim dhe reproduksion të muzikës, i bazuar në katër kanale të ndryshme, të ndara në dy çifte, përpara dhe mbrapa, majtas dhe djathtas. Ky është një synim, për të rikrijuar hapësirën tredimensionale,...

QuickTime

Shqip: QuickTime

Formati për video i zhvilluar nga Apple. [QuickTime](#) është i paraparë për

faqe të internetit dhe përkrahë edhe zërin. Skema e kompresionit e përdorur në këtë format është ideale për internet. Vëzhgimi i [QuickTime](#) skedave bëhet përmes plugin që mund të ...

[qwerty](#)

Shqip: qwerty

Qwerty është formacion i tastaturës së kompjuterit (më herët e përdorur për shtypshkronjë). Emri i formacionit apo shpërndarjes së pullave vjen nga pozita e germave Q, W, E, R, T dhe Y të cilat janë të vendosura në rreshtin e parë të germave po në kë...

[Radar](#)

Shqip: Radar

RAadio Detection And Ranging. Fjala radar, edhe pse akronim, paraqet një fjalë integrale dhe shkruhet me shkronja të vogla. Fillimisht ka qenë një sistem për zbulimin e prezencës dhe përcaktimin e distancës së objekteve,...

[RAM](#)

Shqip: RAM

(I)

Shkurtesë për Random Access Memory. [RAM](#) është element që bën ruajtjen e informatave, ku informata mund të lexohet në çfarë do rendi. Në [RAM](#) zakonisht mund të shkruhet dhe lexohet, dhe përdoret për informatat të cilat vazhdimisht ndyshojnë....

[RCAT](#)

Shqip: RCAT

Shkurtesa për Recess Channel Array Transistor. Kjo teknologji që është pronë e Samsung është publikuar me 2003. [RCAT](#) zvogëlon hapësirën e tranzitorave duke zbatuar dizajnin struktural 3D. Kjo rrit nivelin e integritetit dhe denzitetin e hapësirës për t...

[RDRAM](#)

Shqip: RDRAM

RDRAM (Rambus Dynamic Random Access Memory) është nënsistem i memories që ofron transfer të shënimeve deri në 1.6 trilion bajta për sekondë. Nënsistemi është i përbërë nga [RAM](#), [RAM](#) kontrolleri dhe bus-i

që lidhë RAM për mikroprocesorë....

regex

Shqip: regex

regex është shkurtesë për "[regular expressions](#)". Regex është varg (Ang:string) me simbole të veçanta të cilat e përshkruajnë një bashkësi të vargjeve në bazë të rregullave sintaksore. Regex përkrahen nga shumë gjuhë programuese dhe editor teksti për ...

recursion

Shqip: rekurzion

Procesi kur një funksion e thërret(aktivon) vetveten derisa të arrihet një kusht i caktuar i ndaljes.

Resistor

Shqip: Rezistor

Komponenta elektrike që reziston, kufizon apo e rregullon ardhjen e energjisë elektrike në rrjetin elektrik.

RF

Shqip: RF

Shkurtesë për Radio Frequency. [RF](#) është sistem telemetrik për transmetimin e shënimeve nëpër frekuenca të radios. [RF](#) janë valët në brezin prej 10 KHz deri më 300 GHz.

RFC

Shqip: RFC

RFC është shkurtesa për Request For Comments. Kjo është një mbledhje e madhe e dokumenteve që përshkruajnë protokolet, sistemet dhe procedurat e përdorura nga interneti. P.sh. protokolet si [IP](#), [SNMP](#), [TCP](#),...

RFID

Shqip: RFID

Radio Frequency Identification është teknologji që përdoret për identifikim. Në [RFID](#) radio frekuencat përdoren për transmetimin e sinjalit i cili identifikon apo përmban shënimet e nevojshme për ndonjë qëllim....

RISC

Shqip: RISC

Akronim për "Reduced Instruction Set Computer". RISC është arkitekturë e procesorëve që përdorë më pak instuksione për të kryer operacione të ndryshme. Procesorët RISC përmbajnë më pak tranzistorë sesa Procesorët CISC....

Streaming

Shqip: Rrjedhje

Është një teknikë e leximit të skedarëve nga Interneti (file), që mundëson leximin e tyre pa ndërprerje, duke rrjedhur. Kjo mundësohet duke përdorur një memorie për ndërmjetësim, e cila paraprakisht akumulon një sasi të caktuar të paketave me të dhën...

neural network

Shqip: rrjeta neurale

Rrjeta neurale është lloj i Intelgjencës Artificiale e cila provon të imitojë mënyrën e punës së trurit të njeriut. Në vend se të përdoret modeli digjital i llogaritjeve (përmes 1 dhe 0), rrjeta neurale punon duke krijuar lidhjet mes elementeve proc...

Advanced Digital Network

Shqip: Rrjeti Digjital i Avancuar

ADN ose Advanced Digital Network është lidhje 56Kbps "leased-line" ose lidhje e kontraktuar.

ADSL Router

Shqip: Rrugëzuesi ADSL

Është pajisje që shërben për ndërlidhjen e një rrjeti lokal (PAN, LAN) me rrjetet tjera më të mëdha për transmetimin e të dhënave, siç është Interneti, sipas teknologjisë ADSL. Kjo pajisje funksionon sikur rrugëzues (router) për rrjetin lokal,...

RSA

Shqip: RSA

Teknologji enkriptuese e bazuar në çelsin publik e zhvilluar nga RSA Data Security Inc. RSA është shkurtesa për Rivest, Shamir dhe Adelman, zbuluesit e kësaj teknike. RSA është e bazuar në parimin që shumëzimi i dy numrave prim është i lehtë por zbul...

Gjuha e Definicioneve: Shqipe / Duke Shfletuar: S

SCP

Shqip: SCP

Secure Copy (apo shkurtimisht [SCP](#)) është mënyra e transferit të skedave kompjuterike në mes të makinave nëpërmjet të protokolit [SSH](#). Termi [SCP](#) mundet të shfrytëzohet për t'iu referuar ose protokolit SCP ose programit SCP....

SCSI

Shqip: SCSI

Shkurtesë për [Small Computer System Interface](#), [SCSI](#), e lexuar si "Scuzzy", është e dyta e cila përdoret më së shpeshti si interfejs për disqe. I ndryshem nga standardet tjera, [SCSI](#) është i aftë të përkrah tetë(8) paisje,...

SD

Shqip: SD

Shkurtesë për Secure Digital. Këto kartela memorike kanë madhësinë e një pullës postale. [SD](#) nuk i humb shënimet kur shkaktohet energji elektrike. Këto pajisje memorike të gjendjes të pandërprerë (solid state) nuk kanë pjesë lëvizëse....

SDK

Shqip: SDK

Shkurtesë për Software Development Kit. [SDK](#) është paket i veglave, skedave dhe kodeve burimore që i ndihmojnë zhvilluesit të krijojnë softuer për ndonjë teknologji specifike. Ekziston numër i madh i [SDK](#) për [Java](#),...

SFD

Shqip: SFD

SFD është shkurtesë për Software Freedom Day. Kjo ditë e filluar me 28 Gusht 2004 ka për qëllim përhapjen e informimit mbi softuer të hapur dhe falas ose Free and [Open Source](#) Software (FOSS). Si pjesë e festimit është organizimi i mbledhjeve,...

SGSN

Shqip: SGSN

Shkurtesa për Serving [GPRS](#) Support Node. Kjo nyje e [GPRS](#) infrastrukturës ka rolin e mbartjes së paketave të shënimeve nga dhe deri te stacionet mobile në zonën e caktuar të shërbimit. Detyrat e [SGSN](#) janë drejtimi dhe transferi i paketave,...

[SIP](#)

Shqip: SIP

Shkurtesa për Session Initiation Protocol. Ky është standard i specifikuar nga [Internet](#) Engineering Task Force ([IETF](#)) në [RFC](#) 2543. [SIP](#) përdoret për nisjen, menagjimin dhe ndërprerjen e sesioneve (ang: session) interaktive mes një ose më shumë përdorues...

[overclock](#)

Shqip: sipërmatje

Procesi i caktimit të shpejtësisë së procesorit mbi shpejtësinë e lejuar apo të caktuar. Gjatë këtij procesi ndryshon forca elektrike në procesor dhe si pasojë nevojitet sistem i mirë ftohës. Në shumë raste ftohja nuk është e mjaftueshme dhe procesor...

[file-system](#)

Shqip: sistem-skedar

Metodat dhe strukturat e shënimeve të cilat sistemi operativ i përdor për t'i përcjellur skedat në disk apo [particion](#). [SS](#) gjithashtu nënkupton mënyrën se si skedat dhe particionet janë të organizuara në disk....

[Kill File](#)

Shqip: skedar filtrues

Është skedar brenda një programi kompjuterik (file), i aftë të bëjë filtrimin e një teksti sipas kriterëve të paracaktuara. Ky filtrim mund të përdoret te posta elektronike (e-mail) apo te forumet (forum),...

[SMS](#)

Shqip: SMS

SMS është shkurtesa për [Short Message Service](#) ku kjo paraqet shërbimin që ofron dërgimin e mesazheve të shkurtra (zakonisht të quajtura "tekst mesazhe", apo "[SMS](#)-a") ndërmjet pajisjeve mobile, si dhe ndërmjet lidhjeve tokësore....

[SMTP](#)

Shqip: SMTP

SMTP (Simple Mail Transfer Protocol) - Protokol me anë të cilit bëhet transferi i postës elektronike (e-mail) në rrjetë. Ky protkol përdorë [TCP/IP](#) që të realizohet lidhja. Ky protokol zakonisht përdorë [TCP](#) portin 25....

[SNMP](#)

Shqip: SNMP

SNMP (Simple Network Management Protocol) - Protokol standard i internetit për menaxhim të rrjetave. [SNMP](#) përbëhet prej dy pjesëve: Agjentët që janë programe që monitorojnë pajisje të ndryshme individuale në rrjeta,...

[Nagware](#)

Shqip: Softuer qortues

Është program i cili mund të shfrytëzohet falas (freeware), por i cili gjatë përdorimit shumë shpesh përkujton shfrytëzuesin, se ky program ka vlerën e vet dhe se do të ishte mirë të paguhej për shfrytëzimin e tij....

[Solaris](#)

Shqip: Solaris

Solaris është sistem operativ nga Sun Microsystems. [Solaris](#) është zbatim i [UNIX](#). [Solaris](#) gjithashtu njihet me emrin Sun OS. Ky OS është i parashikuar për serverë dhe përdoret për makina kritike si [DNS](#) serverët qëndrorë të internetit....

[NOS](#)

Shqip: SOR

NOS është shkurtesë për Network Operating System apo Sistem Operativ në Rrjet. Ky është sistem operativ që përmban funksione speciale për lidhjen e makinave dhe pajisjeve në [LAN](#). [NOS](#) zbaton protokolet si dhe drejtuesit (driver) për harduerin e lidhur...

[SPAM](#)

Shqip: SPAM

Përdorimi i padrejtë i listës së e-postës, [USENET](#) apo metodave tjera të komunikimit për të dërguar porosinë e njejtë personave të cilët nuk kanë kërkuar këtë porosi. Termi [SPAM](#) është ngjitur e-postës së tillë duke i'u falemnderuar skeçit të Monty P...

SPARC

Shqip: SPARC

Shkurtesa për Scalable Processor Architecture. [CPU](#)-të [SPARC](#) mund të jenë 32 ose 64 [bit](#) dhe janë të bazuar në [RISC](#). [SPARC](#) është zhvilluar nga Sun Microsystems dhe është lëshuar si arkitekturë e hapur. Këto [CPU](#) kanë gjetur përdorim sidomos në makina me...

spin

Shqip: spini

Në Fizikë [spini](#) është momenti këndor i grimcave nën-atomike. Në Fizikën e Grimcave dhe Atomike ekzistojnë dy lloje të momentit këndor: spini dhe momenti këndor orbital. Spini është karakteristika themelore e gjitha grimcave elementare....

spintronic

Shqip: spintronika

Kjo fushë e re e Fizikës ka të bëjë me fenomenet e varura nga [spini](#) i grimcave të cilat i'u zbatohen pajisjeve elektronike. Spintronika manipulon jo vetëm ngarkesën e elektroneve por edhe spinin e tyre duke i'u mundësuar funksione të reja....

SRAM

Shqip: SRAM

SRAM është shkurtesë për Static Random Access Memory. Është tip i memories së paqëndrueshme (Ang: volatile) i cili i mban shënimet përderisa ka furnizim me rrymë elektrike. [SRAM](#) dallon nga [DRAM](#) nga ajo që nuk ka nevojë për freskime të shpeshta sikurs...

SSH

Shqip: SSH

Secure Shell është e zhvilluar nga [SSH Communications Security Ltd](#). [SSH](#) është program që shërben për lidhje mes makinave nëpër rrjet, sikur [telnet](#) por në mënyrë të sigurtë. SSH ofron autentifikim dhe sigurim të lidhjes dhe është e paraparë si zëvendë...

SSI

Shqip: SSI

Shkurtesë për [Small-Scale Integration](#), [SSI](#) është një lloj i çipit, ku një arkitekturë ka të paktën 30 [transistor](#) për çip.

SSL

Shqip: SSL

Shkurtesa për Secure Socket Layer. [SSL](#) është zhvilluar nga Netscape për transmetimin e dokumenteve private përmes internetit. [SSL](#) punon përmes çelësit privat i cili përdoret për enkriptimin e shënimeve dhe bën sigurimin e tërë sesionit....

Stack

Shqip: Stack

Stack është strukturë e të dhënave, e bazuar ne konceptin LIFO (Ang: Last in, First Out), që do të thotë elementi që futet i fundit në një strukturë, ai edhe do të nxirret i pari. [Stack](#) është koncept që përdoret shumë në shkencat kompjuterike....

static

Shqip: statik

(I)

Në gjuhë programuese [static](#) është fjalë kyçe që definojnë sferën e variablave dhe funksioneve. Gjithashtu njihen si variabla të klasave.

(II)

[IP](#) statike është ajo [IP](#) që nuk ndryshon dinamikisht. Pra IP adresë e cila është definuar me dorë dhe jo...

steganography

Shqip: steganografi

Shkenca e fshehjes së porosive, jo kriptimit të tyre. Steganografia bënë fshehjen e porosive brenda ndonjë skede, zakonisht pamje apo fotografi. Metodatat tradicionale steganografike ishin shpuarja e shkronjave në ndonjë letër duke krijuar birra të vogë...

STM

Shqip: STM

(I)

Shkurtesa për Synchronous Transfer Mode. Proces i transmetimit të shënimeve në sekuencë për intervale të rregullta kohore.

(II)

Termin i ri për TDM tradicional për t'a dalluar nga ATM. [STM-1](#) është njësi më e madhe standarde e kapacitetit,...

Sunbird

Shqip: Sunbird

SunBird është projekt i [Mozilla](#) për krijimin e një aplikacioni vetekzistues për kalendarim. SunBird është e ndërtuar në XUL gjuhën e interface-ave. Ky prodhim është për ata që përdorin shfletues dhe klient tjetër të e-postës....

SWAP

Shqip: SWAP

(I)

[SWAP](#) do të thot zëvendësimi i faqeve (page) dhe segmenteve (segment) të shënimeve në [memorie](#). Kjo metodë përdoret në makina për të manipuluar skeda që janë më të mëdha sesa [RAM](#)-i i makinës. Shënimet që nuk mund të vendosen në [RAM](#) vendosen në dis...

Gjuha e Definicioneve: Shqipe / Duke Shfletuar: T

TB

Shqip: TB

TB është shkurtesë për TerraByte. Një [TB](#) i ka 1024 [GB](#).

TCP

Shqip: TCP

Shkurtesë për Transmission Control Protocol. [TCP](#) është një nga protokolet kryesore në rrjeta [TCP/IP](#). Ky është protokol i orientuar në lidhje (connection oriented) që bënë pjesë në shtresën transport (transport layer)....

Information Technology

Shqip: Teknologji e informacionit

Është term me të cilin përfshihen të gjitha teknologjitë që përdoren për krijimin, përpunimin, ruajtjen, transmetimin, këmbimin dhe përdorimin e informacioneve në të gjitha format e saj, siç janë: shënimet e biznesit,...

ADSL Technology

Shqip: Teknologjia ADSL

Është teknologji e cila mundëson shfrytëzimin e një linje klasike telefonike, përveç për biseda telefonike edhe për transmetimin e të dhënave, në të njëjtën kohë. Kjo bëhet e mundur, duke pas parasysh faktin se një tel i bakrit me prerje tërthore pre...

texture

Shqip: tekstura

Karakteristika e sipërfaqës së materialeve të vërteta, vizuele apo të simuluar. Teksturat e materialeve të vërteta mund të ndihen me gishta apo prekje ndërsa ato të materialeve të simuluar "nënkuptohen" nga forma e krijuar në [medium](#),...

ToIP

Shqip: Telefonia nëpër rrjete që përdorin protokollin IP

Telephony Over [Internet](#) Protocol. Shpesh dhe më shkurt quhet telefonia nëpër Internet, pasi që në shumicën e rasteve bëhet fjalë për rrjetin e Internetit. Paraqet shërbimin për komunikim telefonik (telephony),...

HDTV

Shqip: televizion me definicion të lartë

High Definition TV. Kështu quhet teknologjia e re që tenton të rris kualitetin e fotografisë në televizionin digjital (definition, digjital). Kjo bëhet duke e rritur numrin e linjave që e përbëjnë fotografinë,...

Telnet

Shqip: Telnet

Telnet është protokol standard i cili ju mundëson komunikim me sisteme të largëta nëpërmes terminalit në sistemin e juaj. [Telnet](#) komunikon nëpërmes [TCP/IP](#) protokollit dhe dërgon shënime të cilat sistemi i largët i paraqet apo krijon....

TFT

Shqip: TFT

TFT është shkurtesë për Thin-Film-Transistor. Kjo është teknologji për ekrane të kristalit të lëngët (LC apo liquid cristal) e cila ofron pamjet të kualitetit të lartë. [TFT](#) ekrane zakonisht përdoren në kompjutera fletore....

HST

Shqip: THH

Teleskopi Hapësinor Hubble (shkurtimisht [THH](#)) apo në gjuhën Angleze [Hubble Space Telescope](#) (shkurtimisht [HST](#)) është një teleskop që gjendet në orbitën e Tokës. THH u emërua pas astronomit Edwin Hubble për shkak të kontributeve të tij,...

[TPS](#)

Shqip: TPS

Shkurtese për "transactions per second" (transaksione për sekond), matje që përdoret për përcaktimin e transaksioneve të procesuara, p.sh. në sistemet e orientuara transaktive.

[transistor](#)

Shqip: tranzistor

Tranzistori është pajisje elektronike e përdorur në makina dhe kompjutera. Tranzistori është i ndërtuar nga gjysmëpërçuesit si germanium dhe silikon për të cilin bëhen tri lidhje elektrike. Ndotjet apo papastërtitë në gjysmëpërçues përdoren për të kr...

[three laws of robotics](#)

Shqip: tre ligjet e robotikës

Tre ligjet e robotikës janë ligje fantastiko-shkencore të shkruar nga autori e biokimisti i njohur Isaac Asimov sipas të cilave çdo rrobot duhet t'i përmbahet. Këto ligje u paraqiten për herë të parë në shkrimin "Runaround" (1942) dhe vijojnë:

Gjuha e Definicioneve: Shqipe / Duke Shfletuar: U

[UART](#)

Shqip: UART

UART apo Universal Asynchronous Receiver/Transmitter është një mikroqip me programe që kontrollojnë lidhjet (interface) të kompjuterëve për pajisje serike (serial). Më saktësisht i ofron makinës lidhjen RS-232C Data Terminal Equipment (DTE) për të ko...

UAV

Shqip: UAV

(I)

UAV janë mjete, makina autonome (robot) të cilat nuk kanë nevojë të njeriut për t'u kontrolluar. UAV përdoren për qëllime shkencore dhe ushtarake. Shembuj të UAV në shkencë janë robotët nën-ujorë për studimet e oqeanëve....

UDP

Shqip: UDP

Shkurtesë për User Datagram Protocol. UDP është protokol i rrjetave që punon në nivelin e transportit sipas modelit të rrjetave të OSI-t apo edhe atij të TCP/IP. UDP-ja dërgon mesazhe të quajtura datagram-e prej burimit në destinacion....

Web

Shqip: Ueb

Është njëri nga shërbimet (sistemet) më të rëndësishme që i ofron Interneti, sipas të cilit mund të kërkojmë, të gjejmë dhe afishojmë në ekran të kompjuterit informacione të ndryshme, në forma të ndryshme,...

wiki

Shqip: uiki

Wiki (shqiptuar uiki) është lloj i ueb-faqes që i lejon vet vizitorët me lehtësi të shtojnë, largojnë, apo redaktojnë përmbajtjen. Lehtësia e një ndërveprimi të tillë, i bën uikit shumë të përshtatshëm për bashkëpunim ndërmjet personave të ndryshëm q...

Wikipedia

Shqip: Uikipedia

Wikipedia (e shqiptuar Uikipedia) është një ueb-enciklopedi e hapur e cila është e ofruar në gjuhë të shumta, përfshirë edhe gjuhën Shqipe. Emri Wikipedia rrjedh nga fjalët angleze "wiki" dhe "encyclopedia"....

ADSL

Shqip: Unazë e Abonentëve Digjital me Shpejtësi Asimetrike

(I)

Shqip: Linjë e abonentit digjital me shpejtësi asimetrike
Asymmetric Digital Subscriber Line. Është linja ekzistuese klasike telefonike, e cila përdoret në të njëjtën kohë por në brezat e ndryshëm

frekuencor (frequency band),...

UNIX

Shqip: UNIX

Sistem "time-sharing" bashkëveprues i ndërtuar me 1969 nga Ken Thompson. Thompson krijoi UNIX për të luajtur lojra kompjuterike në PDP-7 të tij. Bashkëautorë i UNIX konsiderohet edhe krijuesi i gjuhës programuese C,...

USENET

Shqip: USENET

USENET vjen nga fjalët Users Network. Sot USENET mund të gjindet e shkruar edhe si usenet (me shkronja të vogla). Ky është sistem i distribuar i tabelave-buletin (bulletin-board) i krijuar nga makinat UNIX....

UT

Shqip: UT

(I)

UT apo Universal Time është zona kohore e ngjajshme me GMT, apo Greenwich Mean Time që fillon nga meridiani 0 i cili kalon nëpër Greenwich/Britani. UT është kohë universale dhe është e njejtë kudo në botë....

UTC

Shqip: UTC

Coordinated Universal Time (UTC) është realizim atomik i Greenwich Mean Time (GMT). Kjo kohë është e bazuar në kohën atomike (TAI) që është mesatarja e orëve në më se 50 laboratore nëpër botë. UTC është bazë për matje kohore në botë....

UV

Shqip: UV

UV është shkurtesë për Ultraviolet. Rrezatimi UV është në gjerësi valore mes 4000 angstrom njësi (Å) dhe 150 (Å). Rrezatimi natyror UV krijohet nga Dielli. UV ndahet në tri kategori përnga gjerësia valore,...

Gjuha e Definicioneve: Shqipe / Duke Shfletuar: V

[VBScript](#)

Shqip: VBScript

Visual Basic Scripting Edition (shkurtimisht [VBScript](#)) është një gjuhë skriptuese e llojit [Active Scripting](#) që interpretohet nga [Windows Script Host](#) i [Microsoft](#)-it. Sintaksa e [VBScript](#) është e bazuar në atë të gjuhës programuese [Microsoft Visual Basi...](#)

[eigenvector](#)

Shqip: vektor vetjak

Në algjibrën lineare, vektorët vetjak (Ang: [eigenvector](#)) të operatorit linear janë vektorët jo-zero të cilët kur operohen me ndonjë operator, rezultojnë në shumëfishin skalar të vetvetes. Skalari i asocuar me vektorin vetjak quhet [vlerë vetjake](#) (Ang:...

[VGA](#)

Shqip: VGA

VGA - Shkurtesë e Video Graphics Array, sistem analog për paraqitje grafike në [PC](#), e zhvilluar nga IBM. Ndryshe nga stadardet tjera grafike për [PC](#), (MDA, CGA, dhe EGA), [VGA](#) përmban analog sinjale. [VGA](#) përmban rezolucion maksimal prej 640x480 pikselav...

[Virtual](#)

Shqip: Virtual

Virtual/e është kuptim i kundërt nga real/e. Prandaj, [virtual](#)/e është çdo gjë që nuk ekziston në realitet, por është produkt i imagjnatës njerëzore. Në teknologjinë e informacionit ([IT](#)), virtuale është çdo gjë që nuk është harduerike (hardware),...

[eigenvalue](#)

Shqip: vlerë vetjake

Në algjibrën lineare, numri quhet [vlerë vetjake](#) (Ang: [eigenvalue](#)) e matricës nëse ekziston një vektor jo-zero ashtu që matrica e shumëzuar me atë vektor rezulton në po atë vektor shumëzuar me skalarin vlerë vetjake....

[VLSI](#)

Shqip: VLSI

Very-large-scale integration (shkurtimisht [VLSI](#)) është procesi i krijimit të qarqeve të integruara në një çip të vetëm me anë të bashkimit të mijëra qarqeve të bazuara në tranzitor.

[VLSI](#) filloi gjatë 1970-ve kur gjysmëpërçuesit dhe teknologjitë ko...

[VLT](#)

Shqip: VLT

VLT është shkurtesë për Very Large Telescope të [ESO](#). [VLT](#) përbëhet nga katër teleskopa 8 m. Këta teleskopa mund të punojnë ndamas ose së bashku. Kur punojnë së bashku drita e mbledhur është e barabart me atë të një teleskopit 16 metra....

[VM](#)

Shqip: VM

VM është shkurtesë për [Virtual](#) Memory. Kur në [memorie](#) nuk ka vend të mjaftueshem për të gjitha udhëzimet, të nevojshme për [CPU](#), atëherë kompjuteri instalon të ashtuquajturen [Virtual](#) Memory skedë. Kështu,...

[VMS](#)

Shqip: VMS

VMS ([Virtual](#) Memory System) është sistem operativ nga Digital Equipment Corporation (DEC) që punon në makina më të vjetra. [VMS](#) ka origjinën nga 1979 dhe përdorej si sistem operativ në VAX kompjuterët e DEC....

[VNDS](#)

Shqip: VNDS

VNDS është shkurtesë për VeriSign® Naming and Directory Services. Ky shërbim i lejon shfrytëzuesve, aplikacioneve dhe pajisjeve të zbulojnë njëri tjetrin lehtë në rrjeta të ndryshme.

[VoIP](#)

Shqip: VoIP

VoIP, apo Voice Over [Internet](#) Protocol (Zë nëpërmes të protokolit internetor) është një teknologji e cila mundëson komunikim në mes dy palëve duke përdorur protokolin e internetit ([IP](#)). Për të dërguar shënime zërore tani përdoren rrjetat publike tele...

[black hole](#)

Shqip: vrimë e zezë

Vrimë e zezë është koncentrim i madh i masës në një vend që bën ritjen e forcës gravitacionale aq shumë sa që nuk lejon asgjë të del nga ajo e njëkohësisht as dritën. Vrimat e zeza kanë madhësi të ndryshme,...

Gjuha e Definicioneve: Shqipe / Duke Shfletuar: W

[WAP](#)

Shqip: WAP

Shkurtesa për Wireless Application Protocol, specifikim i sigurt që lejon përdoruesve të lidhen për informata përmes pajisjeve [dorëmbajtëse](#) si telefonat mobil dhe PDA. [WAP](#) përkrahë shumicën e rrjetave patela si CDPD,...

[wardriving](#)

Shqip: wardriving

Wardriving është termin i ri që përshkruan një fenomen shoqëror të zhvilluar si pasojë e rrjetave patela. Wardriving është aktivitet qëllimi i të cilit është zbulimi i rrjetave patela duke u shëtitur në automjet....

[WECA](#)

Shqip: WECA

Emri i vjetër i [WiFi](#) Alliance. Shkurtesa qëndron për Wireless [Ethernet](#) Compatibility Alliance.

[WEP](#)

Shqip: WEP

Shkurtesa për Wired Equivalent Privacy. [WEP](#) është i definuar nga standardi [IEEE](#)-802.11 për të ndaluar lidhjen e personave të pa-autorizuar dhe kapjen e paketave të rrjetit patela. [WEP](#) punon përmes çelsave 64 ose 128 [bit](#) të cilët vendosen në makinat e...

WiFi

Shqip: WiFi

Shkurtesë për Wireless Fidelity. Kjo shprehje përdoret për emërtimin e 802.11 rrjetave në përgjithësi dhe është shpallur nga Wi-Fi Alliance. Wi-Fi Alliance bën testimin dhe miratimin e prodhimeve të cilat mund të bashkëpunojnë me prodhimet e prodhues...

Wii

Shqip: Wii

Wii (shqiptuar: ui) është konzoli i gjeneratës së shtatë për video-lojëra nga kompania Nintendo, dhe është pasardhësi i Nintendo GameCube. Për momentin [Wii](#) është konkurrent direkt me Xbox 360 të [Microsoft](#) dhe PlayStation 3 të Sony....

Wikimania

Shqip: Wikimania

Wikimania është një konferencë për shfrytëzuesit e [wiki](#) projekteve që janë të drejtuar nga Fondacioni Wikimedia.

Temat të cilat kryesisht përfshihen në këto konferenca janë:

- Studimet, hulumtimet dhe eksperimentet mbi [Wikipedia](#) si dhe projektet ...

Windows 2000

Shqip: Windows 2000

Codenamed Odyssey, gjithashtu njihet si [Windows 2k](#), [Windows 2000](#) është një sistem operativ i lansuar nga Microsofti në Shkurt 2000 që është bazuar kernelin e [Windows NT](#). [Windows 2000](#) përfshin tipare të avancuara që janë mbështetje e mire për hardwar...

Windows ME

Shqip: Windows ME

Codenamed Millennium, [Windows ME](#) është shkurtesë për [Windows Millennium](#) dhe është një sistem i lansuar nga [Microsoft](#)-ti me 19 qershor 2000. [Windows ME](#) është freskim prej Windows 98 ku përfshin përmirësime,...

Windows NT

Shqip: Windows NT

Ky sistem operativ ne formë origjinale është e lansuar si [Microsoft](#)

[Windows](#) NT 3.1 i cili ka interfejsa të njëjtë sikurse Windows 3.1x me rrjeta të avancuara kompatible dhe mbeshtetje të harduerit. Në Gusht 1996 [Microsoft](#)-i lansoi [Windows NT](#) 4....

[Wine](#)

Shqip: Wine

Wine është një projekt softuerik që e bën të mundur ekzekutimin e programeve për sistemin operativ [Microsoft Windows](#) në kompjuterët personal që funksionojnë në ndonjë sistem operativ të llojit [UNIX](#) dhe që përfshijnë X Window sistemin....

[WLAN](#)

Shqip: WLAN

Është rrjetë [LAN](#) por që përdor mediumin [pa tela](#) ([wireless](#)). [WLAN](#) punon në protokolet e njëjta si [LAN](#) me tela. Standardi i specifikuar për [WLAN](#) është [IEEE](#) 802.11.

[WordPress](#)

Shqip: WordPress

WordPress është një [blog](#) sistem i cili është i shkruar në gjuhën programuese [PHP](#) dhe është i mbështetur nga [MySQL](#) sistemi për menaxhimin e të dhënave. Ky [blog](#) sistem ka kodin burimor të hapur dhe distribuohet falas nën licencën [GNU GPL](#)....

[WYSIWYG](#)

Shqip: WYSIWYG

WYSIWYG është shkurtesa për "What You See Is What You Get". Ky term përdoret në kompjuterikë për të përshkruar sistemin ku dukja e përmbajtjes gjatë editimit do të jetë shumë e ngjashme me dukjen përfundimtare....

Gjuha e Definicioneve: Shqipe / Duke Shfletuar: X

[Xeon](#)

Shqip: Xeon

Xeon është procesor ([CPU](#)) 400 MHz Pentium nga [Intel](#) i krijuar për serverë. Në pllakat amë (motherboard) të [Intel](#)-it mund të lidhen deri më tetë [Xeon CPU](#) për procesim të shumtë (multiprocessing).

XML

Shqip: XML

XML shkurtesë për Extensible Markup Language. [XML](#) është gjuhë/mjet që mundëson përshkrimin, ruajtjen, dërgimin, dhe shkëmbimin e informatës në mes aplikacioneve të ndryshme dhe në [Internet](#). Në strukturë,...

XOR

Shqip: XOR

XOR (exclusive [OR](#)) Lloj i derës ([gate](#)) logjike ku dalja është 1 vetëm nëse dy hyrjet janë të ndryshme, përndryshe nëse hyrjet janë të njejta, dalja është 0.

Gjuha e Definicioneve: Shqipe / Duke Shfletuar: Y

Y-modem

Shqip: Y-modem

Y-[modem](#) është protokol i modemëve. Ekzistojnë [Y-modem](#) dhe [Y-modem](#)-g protokolet. Të dy protokolet kanë madhësi të bllokut 1024 bajta (bloqet në të cilat informata ndahet). Frekuenca e përgjigjes apo dërgimi i ACK ose [NAK](#) përgjigjeve në Y-modem ndodh p...

constellation

Shqip: yllësi

Yllësi është formacion i yjeve në qiell i emërtuar pas personave, shtazëve apo objekteve (zakonisht nga mitologjia ilire/kelte/greke/romake). Astronomët përdorin yllësitë për të caktuar pikat në hapësirë....

Gjuha e Definicioneve: Shqipe / Duke Shfletuar: Z

Z-modem

Shqip: Z-modem

Z-[modem](#) është protokol i modemëve. Madhësia bllokut në të cilin ndahen informatat është 512 bajta. Frekuenca e përgjegjëse apo dërgimi i ACK ose [NAK](#) përgjigjeve ndodh vetëm në raste kur gabimet në transmetim detektohen....

Upsizing

Shqip: Zgjerim

Zgjerim (rritje, zmadhim) Është proces i zëvendësimit të një sistemi të vogël, që mund të jetë edhe kompjuterik, me një sistem tjetër më të madh. Zakonisht nënkupton pajisje, pothuaj identike për nga funksionaliteti,...

Jamming

Shqip: Zhurmim

Ose shurdhim, pengim, përzierje. Është veprim i qëllimshëm, i emetimit të sinjaleve elektrike për të krijuar interferencën elektromagnetike (EMI), e cila do të pengoj apo bllokoj pranimin e sinjaleve nga një pranues ([receiver](#))....

ZigBee

Shqip: ZigBee

Është njëra nga teknologjitë [pa tela](#), që përdoret për lidhjen e pajisjeve periferike me ato qendrore (peripheral devices, [CPU](#)). Funksionon, sikur edhe [WiFi](#), në brezin frekuencor rreth frekuencës 2.4GHz....

B4MKP-KP9YP-7TBQ4-7T4XF-MTGWY TXF6Y-H24H8-H8YHX-46DY2-HCPCD
TXF6Y-H24H8-H8YHX-46DY2-HCPCD TXF6Y-H24H8-H8YHX-46DY2-HCPCD
B4MKP-KP9YP-7TBQ4-7T4XF-MTGWY B4MKP-KP9YP-7TBQ4-7T4XF-MTGWY
TXF6Y-H24H8-H8YHX-46DY2-HCPCD